



Në mbështetje të nenit 145, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4,21,22 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189), neni 7 (pika 2.3 dhe 4) neni 15 (pika 1, 2 dhe 3) të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037), Udhëzimit Administrativ për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Larte (Nr. 25/2012), Udhëzimit Administrativ për Themelimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (Nr. 11/2004), Udhëzimit Administrativ mbi Kriteret dhe Procedurat për Akreditimin e Shkollave të Larta Profesionale dhe Shkollave të Larta Teknike në Republikën e Kosovës (Nr. 12/2009), dhe Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë, në mbledhjen e XXXII të mbajtur më 06.11.2014, duke u bazuar në rekomandimin e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit mori:

V E N D I M

I. Akreditohen programet e studimit të Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Prishtinës:

- Mësimdhënie në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe/ MA (60 ECTS)
- Mësimdhënie në Shkencat Sociale (Drejtimet: Histori; dhe Histori dhe Edukatë Qytetare)/ MA (60 ECTS)
- Mësimdhënie në Teknologji dhe TI/ MA (60 ECTS)
- Mësimdhënie në Matematikë/ MA (60 ECTS)
- Mësimdhënie në Shkenca Natyrore/ MA (60 ECTS)

për një periudhë dy vjeçare 07 Nëntor 2014 – 30 Shtator 2016.

II. Nuk akreditohen drejtimet e programit Shkenca Sociale/ MA:

- Gjeografi
- Edukatë Qytetare dhe Gjeografi

Arsyetim

III. Duke u mbështetur në dispozitat e shënuara më lartë, dhe në rekomandimet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

IV. Ndaj këtij vendimi lejohet kërkesa për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së brenda afatit të paraparë ligjor.

V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi u dërgohet:

- Universitetit të Prishtinës,
- MASHT-it,
- Arkivit të AKA-së



Dr.sc. Ferdije Zhushi Etemi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë